

## Përbajta :

1. Bilanci në momentin e fillimit të procedurës së likujdimit .....	4
2. Detyrimet e likuidatorit.....	6
3. Përgjegjësitë e likuidatorit.....	7
4. Bilanci në datën e mbylljes së likujdimit. ....	8
5. Veprimet e kryera gjatë procesit të likujdimit. ....	9
6. Rezultati nga Likujdimi.....	10
7. Përfundimi i Likujdimit.....	11

## RAPORTI I LIKUJDIMIT GEOALBANIA UNO Shpk

### Raport Likujdimi GEOALBANIA UNO Shpk

Të nderuar Zotërinj,

Me këtë raport unë kërkoj t'ju informoj për përfundimin e procesit të likujdimit si dhe për paraqitjen e llogarive të likujdimit duke përshkruar në mënyrë të plotë punën e bërë nga momenti i marrjes së funksioneve të likujdatorit e deri në realizimin e tij përfundimtar.

#### 1. Bilanci në momentin e fillimit të procedurës së likujdimit

Pas marrjes së emërimit më 12 Prill 2018, në plotësim të kërkesave të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", neni 198, midis ortakut të vetëm të shoqërisë Geoenergie SPA dhe likujdatorit të shoqërisë Z. Massimo De Petro, u mbajt akti i dorëzimit të detyrës, i dokumentacionit dhe vlerave pasurore të shoqërisë GEOALBANIA UNO Shpk me NIPT: L02212002F.

*Shoqëria GEOALBANIA UNO Shpk është regjistruar sipas Aktit të Themelimit dhe Statutit më datë 12/10/2010.*

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është :

*Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve "Progonat-Lekdush" dhe "Bënçë e Sipërme" tek Autoriteti Kontraktues, ku përfshihet financimi, ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike sipas Kontrates së Koncessjonit Nr.1638 Rep. Nr.424/2 Kol, datë 26.03.2009 e lidhur ndërmjet paleve, "Radici Energie"s.p.a dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjikutikës.*

Akti përfshin bilancin kontabël të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likujdimit, inventarin kontabël të të drejtave dhe detyrimeve, dokumentat ligjore të shoqërisë dhe ato të marrëdhënieve me të tretë.

Në mënyrë të përbledhur Bilanci i çeljes së ikujdimit paraqitet si vijon:

GEOALBANIA UNO Shpk  
Raporti i Likujdatorit

Pasqyra e Pozicionit Financiar në çelje të likujdimit

	Shënime	12 Prill 2018
<b>AKTIVET</b>		
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare		-
<b>Total aktive afatshkurtra</b>		-
 Aktivet afatgjata		
Aktive afatgjata materiale		-
Aktive afatgjata jomateriale		-
<b>Total aktive afatgjata</b>		-
<b>Total aktive</b>		-
 <b>DETÝRIMET</b>		
Detyrime afatshkurtra		
Llogari të pagueshme tregëtare	466,416	
Detyrime tatimore	149,318	
Të tjera detyrime	52,020	
<b>Total detyrime afatshkurtra</b>	<b>667,754</b>	
 Detyrime afatgjata		
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	46,812,292	
<b>Total detyrime afatgjata</b>	<b>46,812,292</b>	
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>47,480,046</b>	
 <b>KAPITALI</b>		
Kapitali i nënshkruar	100,000	
Rezerva të tjera	(1,355,852)	
Fitimi i ushtrimit	(46,238,111)	
<b>Total kapitali</b>	<b>(47,493,963)</b>	
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>	<b>-</b>	

**GEOALBANIA UNO Shpk**  
**Raporti i Likujdatorit**

Pasqyra e Të Ardhurave dhe Shpenzimeve në çelje të likujdimit

Shënime	12 Prill 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	38,885,610
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	154,852
<b>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</b>	<b>(39,123,221)</b>
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	(38,885,613)
2) Të tjera shpenzime	(237,608)
<b>Shpenzime të personelit</b>	<b>(25,110)</b>
1) Paga dhe shpërblime	(10,080)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pension)	(15,030)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	(46,662,733)
<b>Të ardhura të tjera</b>	<b>-</b>
<b>Shpenzime financiare</b>	<b>546,408</b>
2) Shpenzime të tjera financiare	546,408
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>	<b>(46,224,194)</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	<b>-</b>
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	(13,917)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë	-
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>	<b>(46,238,111)</b>
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>	<b>(46,238,111)</b>

## Detyrimet e likujdatorit

### 2.1 Regjistrimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit

Bazuar në Nenin 194 të ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", pasi administratorët kryejnë njoftimin dhe depozitimin e të gjithë dokumentave të nevojshme lidhur me likuiduesin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit njoftojnë gjithashtu Qendrën Kombëtare të Biznesit për regjistrim te çdo ndryshimi për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit.

### 2.2 Administrimi i shoqërisë nga likuiduesit

Sipas Nenit 196 të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" likuiduesi kryen të gjitha funksionet e administratorit nga data e emërimit të tij. Veprimtaria e likuiduesit është subjekt i mbikqyrjes nga ortakët dhe organet drejtuese të shoqerisë në likujdim.

### 2.3 Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

Sipas nenit 197 të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" detyra e likuiduesit është myllja e të gjitha vepprimeve të shoqërisë, realizimi i aktiveve dhe shlyerja e detyrimeve te saj duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Nëse në gjykimin e likuiduesit, reklamimet e ngritura nga kreditorët përfshirë kontributet e pashlyera janë më të mëdha sesa pasuria e shoqërisë tregtare në momentin e likujdimit, atëherë likuiduesi duhet të pezullojë procedurën e likujdimit dhe t'i kerkojë gjykates nisjen e procedurave të falimentit.

### 2.4 Ftesa për kreditorët

Sipas nenit 195 te ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj.

Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj në internet, nëse ka, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të dépoxitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

### 2.5 Mbrojtja e kreditorëve

Sipas nenit 199 te ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" likuiduesi duhet te respektojë afatin prej 3 muajsh nga data e njoftimit të dyte për kreditorët, për të filluar shpërndarjen e aktiveve të mbeturë.

Nëse një kreditor i shoqërisë, i njohur nga likuiduesi, nuk reklamon kërkesat e veta brenda afatit, shuma e të drejtës së tij depozitohet në gjykatë. Nëse e drejta lidhet me mallra, ato magazinohen, duke ia ngarkuar kreditorit shpenzimet e magazinimit.

Në rastet kur detyrimi ndaj kreditorit nuk mund te shlyhet menjëherë, aktivet e shoqërisë mund të shpërndahen vetëm nëse kreditorit i jepet një garanci e përshtatshme.

## 2.6 Shpërndarja e aktiveve

Sipas Nenit 201 te ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" likuiduesi pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, u shpërndan ortakëve apo aksionarëve aktivet e mbetur, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur është parashikuar në statut një ndarje preferenciale.

## 2.7 Bilancet

Sipas Nenit 198 te ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së zyrës së përfaqësimit në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së tij. Në rastet kur procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit dhe pasqyrat vjetore të shoqërisë.

## 2.8 Raporti i likuiduesit, shpërblimi dhe shkarkimi

Sipas nenit 200 ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare" aktivet e mbetur pas shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve dhe shpërbllimit të likuiduesit, së bashku me rimbursimin e shpenzimeve të këtij të fundit për kryerjen e detyrave, u shpërndahen ortakëve ose aksionarëve.

Pas shlyerjes së detyrimeve të zyrës së përfaqësimit ndaj kreditorëve, likuiduesit u paraqesin ortakëve të tjerë të shoqërisë apo asamblesë së përgjithshme një raport për procedurën e likuidimit.

## 2.9 Përfundimi i likuidimit

Sipas nenit 202 të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" pas kryerjes së të gjitha procedurave për likuidimin e shoqërisë, likuiduesi njofton QKB për përfundimin e likuidimit, depoziton Raportin e Likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e saj sipas seksionit V të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

## 3. Përgjegjësitet e likuidatorit

Sipas Nenit 203 të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" Përgjegjësitet e likuidatorit janë:

### 3.1 Përgjegjësia për t'iua përgjigjur kundërshtimeve lidhur me veprimtarinë e tij

Likuidatori ka përgjegjësinë për t'iua përgjigjur kundërshtimeve për veprimtarinë e kryer nga ana e tij deri në momentin e çregjistrimit të kompanisë në likudim nga QKB. Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga QKB.

### 3.2 Përgjegjësia ndaj kreditorëve

Likuiduesit përgjigjen ndaj kreditorëve për dëmet e shkaktuara gjatë procedurës së likuidimit, në përputhje me dispozitat që rregullojnë përgjegjësinë e administratorëve. Krahas likuiduesve, ortakët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe aksionarët përgjigjen ndaj kreditorëve të shoqërisë në mënyrë solidare deri në vlerën që u është shpërndarë. Kreditorët, të cilët nuk kanë depozitar pretendimet e tyre në afat, sipas nenit 194 të këtij ligji, apo kreditorët, për të cilët likuiduesi nuk ka qenë dhe nuk mund të kishte qenë në djeni, nuk kanë të drejtë të ngrenë padi.

GEOALBANIA UNO Shpk  
Raporti i Likujdatorit

**3.3 Afati për ngritjen e padive nga ana e kreditorëve**

Paditë e kreditorëve të cilët janë të njohur për likujdatorin dhe kanë bërë depozitim e pretendimeve të tyre në afat, duhet të ngrihen brenda 3 viteve pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

**4. Bilanci në datën e mbylljes së likujdimit:**

Aktivet, detyrimet dhe kapitalet e veta në fund të likujdimit më 30.11.2018 paraqiten në vijim:

	Shënimë	30 Nëntor 2018
<b>AKTIVET</b>		
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare		-
Total Aktive Afatshkurtra		-
Aktivet afatgjata		
Total aktive afatgjata		-
Total Aktive		-
<b>DETYSIMET</b>		
Detyrime afatshkurtra		
Llogari të pagueshme tregëtare	289,310	
Detyrime tatimore	111,591	
Të tjera detyrime	56,247	
Total Detyrime afatshkurtra		466,229
Detyrime afatgjata		
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	45,891,929	
Total Detyrime afatgjata		46,584,107
Totali i detyrimeve		47,050,336
<b>Kapitali</b>		
Kapitali i nënshkruar	100,000	
Rezerva të tjera	(1,355,852)	
Fitimi i ushtrimit	(45,794,484)	
Total kapitali		(47,050,336)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		-

## 5. Veprimet e kryera gjatë procesit të likujdimit

### 5.1 Përshkrimi i veprimeve proceduriale të likujdimit

Mbi bazën e dokumentacionit dhe inventarëve të aktiveve dhe pasiveve që paraqiten më sipër, unë nisa ushtrimin e funksioneve të likujdatorit për kryerjen e operacioneve të likujdimit, të cilat përshkruhen në vijim:

### 5.2 Vlerësimi i aktiveve të shoqërisë dhe i mjaftueshmërisë së tyre për shlyerjen e detyrimeve

Nga ana ime, në cilësinë e likujdatorit u krye një vlerësim paraprak mbi singjeritetin dhe vërtetësinë e pasurisë së shoqërisë tregtare dhe gjendjes së llogarive kontabile, në datën 15.08.2016, përfshirë detyrimet dhe kontributet e pashlyera, me qëllim vlerësimin nëse aktivet e shoqërise janë të mjaftueshme për të realizuar përbushjen e këtyre pretendimeve.

Ky vlerësim u krye në respektim të kérkesave të pikës 3 të nenit 197 të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008.

Në gjykimin tim paraprak, me cilësinë e likuidatorit të shoqërisë, aktivet e shoqërisë mundësojnë realizimin e procesit të likujdimit.

### 5.3 Dorëzimi i Bilanceve të Shoqërisë

Shoqëria GEOALBANIA UNO Shpk ka detyrim ligjor të dorëzojë pranë autoriteteve tatimore bilancin vjetor të saj dhe e ka përbushur këtë detyrim.

### 5.4 Publikimi i ftesës për kreditorët

Sipas ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", neni 195, likujdatori i shoqërisë fton kreditorët e saj për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Pretendimet e kreditorëve duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të dytë te publikuar në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit(QKB).

Dy njoftimet e parashikuara janë dorëzuar pranë QKB-së.

Pas shpalljes së dytë, ne pritëm ankesat ose pretendimet e kreditorëve por të tilla nuk kishte deri në momentin e hartimit të këtij raporti.

### 5.5 Verifikimet tatimore për rregullsinë e nxjerrjes dhe pagimit të detyrimeve tatimore

Në ligjin "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" është përcaktuar se pas futjes së shoqërisë në procesin e likujdimit, QKB-ja njofton Drejtoreni Rajonale të Tatimeve për regjistrimin e hapjes së procedurës së likuidimit, për tu shprehur nëse shoqëria është në rregull me pagimin e detyrimeve tatimore. Dega e Tatimeve brenda 30 ditëve nga marja e njoftimit, pasi kryen të gjitha verifikimet e duhura lidhur me situatën tatimore i kthen përgjigje QKB-së me kundërshtim ose aprovim të çregjistrit, dhe nëse nuk ndërmerr asnjë veprim, do të thotë se është dakort me vazhdimin e procedurave të çregjistrit.

GEOALBANIA UNO Shpk nuk ka kaluar kontroll tatimor.

### 5.6 Përshkrimi i veprimeve operacionale gjatë likujdimit

#### 5.6.1 Kryerja e veprimeve të likujdimit, deklarimeve tatimore dhe hartimi i pasqyrave financiare për vitin 2018

Gjatë vitit 2018 u kryen deklarimet tatimore të kérkuara nga legjislacioni fiskal si, deklarimet e TVSH-së, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimin mbi pagat, u bënë pagesat e detyrimeve që u krijuan gjatë kësaj periudhe.

Këto veprime u reflektuan në pasqyrat financiare 2018 të cilat ju do i miratoni me vendim të veçantë dhe do të depozitohen në QKB në mbyllje të likujdimit.

### 5.6.2 Veprimet e likujdimit

Transaksionet e kryera gjatë periudhës së likuidimit të shoqërisë paraqiten të përmbledhura si më poshtë:

- Gjatë periudhës nga fillimi i procedurës së likujdimit e deri në përfundim të tij janë kryer pagesa në lidhje me detyrimet tatimore, furnitorët, komisionet bankare e të tjera shpenzime rrjedhëse të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit likujdues.
- Gjatë periudhës së likujdimit çdo muaj është bërë deklarimi i listpagesës në sistemin e tatimeve.
- Shoqëria nuk ka detyrim ndaj ortakëve për financimet e bëra nga ato gjate periudhës së likujdimit.

### 6. Rezultati nga Likujdimi

#### Si efekt i veprimeve te likujdimit :

- GEOALBANIA UNO Shpk ka pasur likujditete në bankë në çelje të likujdimit në vlerën 0 Lek. Në fund të periudhës së likujdimit shoqëria ka gjendje likuiditeti në bankë 0 Lekë.
- GEOALBANIA UNO Shpk i ka mbyllur llogaritë e tjera të arkëtueshme, duke hequr dorë nga pretendimi i tyre dhe duke i kaluar në shpenzime të tjera, përkatësisht TVSH pë tu rimbursuar në vlerën 71,908 lekë.
- GEOALBANIA UNO Shpk ka detyrime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore te muajit Nentor 2018 në vlerën 6,697 Lekë, dhe detyrime të tatimit mbi fitimin viti 2018 në vlerën 104,894 Lekë të cilat do të paguhen në Dhjetor 2018.
- GEOALBANIA UNO Shpk i ka likujduar detyrimet ndaj furnitorëve dhe mbetet per tu paguar Furnitori Mazars për vlerën 289,310 lekë dhe detyrimet e tjera ndaj shoqerise Mazars për vlerën 56,247 lekë, detyrime keto te cilat do te shlyen nga ortaku Geoenergie SPA.

Të dhëna më të detajuara janë dhënë në pasqyrat financiare paraardhëse dhe ato që po paraqiten përmbylljen e procedurave të likujdimit, bashkangjitur raportit.

Raporti i likujdimit dhe pasqyrat financiare të likujdimit që mbajnë datën e raportit, pasi ju të shpreheni përmiratimin e tij me vendimin e shoqërisë GEOALBANIA UNO Shpk, do të depozithohen në QKB, për të kërkuar çrrregjistrimin përfundimtar të shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

## 7. Përfundimi i Likujdimit

Raporti i likujdimit dhe pasqyrat financiare të likujdimit të mbyllura me 30.11.2018 i paraqiten për miratim shoqërisë GEOALBANIA UNO Shpk.

Raporti i likujdimit së bashku me vendimin e shoqërisë për Miratimin e Raportit të Likujdimit të Shoqërisë duhet të depozitohen në QKB, për të kërkuar çregjistrimin përfundimtar të shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Me aprovimin e këtij raporti likujdimi nga shoqëria, GEOALBANIA UNO Shpk konsiderohet e likujduar dhe detyra ime si likuidator e përfunduar.

LIKUJDATORI i GEOALBANIA UNO Shpk

Z. Massimo De Petro



Tiranë më, 20.12.2018